



Pranuar / Dorezuar Puniheno/Prodato Received/Delivered	02.06.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	3230/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.415/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga Arben Mehmeti- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr. 415/2022, të datës 22.04.2022, të parashtruar nga ankuesja _____ nga _____ kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 02.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.415/2022 e datës 22.04.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja-nëpunësja civile _____ : punësuar në Shërbim Korrektues të Kosovës sipas Akt Emërimit të datës 01.09.2016 në pozitën e punës *Asistente Administrative*, me datë 22.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore lidhur me kompensimin e shtesave në shumën prej pesëdhjetë (50) €, sipas Vendimit të datës 01.12.2006 me numër protokollit 02/1151 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 28.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa, Këshilli më datë 18.05.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës 1/7.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.415/2022 e datës 22.04.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 08.03.2022, me numër protokollit 0278; Kërkesë e datës 01.03.2022, drejtuar Zëvendësuesit të drejtorit të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimi i datës 01.12.2006, me numër protokollit 02/1151; Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 15.12.2015; Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 16.06.2016; Akt Emërimi i datës 01.09.2016; Vendimi i datës 01.12.2006, i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë; Përgjigje në ankesë e datës 18.05.2022, me numër protokollit 2895/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar **SEPSE:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses _____ e cila pretendon se organi i punësimit respektivisht Shërbimi Korrektues i Kosovës duhet ti bëjë kompensimin e shtesave në shumën prej pesëdhjetë (50) euro, sikur kolegët tjerë brenda këtij institucioni duke u bazuar në Vendimin me numër 02/1151, të datës 01.12.2006, të nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë.

Nga administrimi i shkresave të lëndës respektivisht sipas sAkt Emërimit të datës 01.09.2016, ankuesi është i emëruar në pozitën e punës *Asistente Administrative* me koeficiente gjashtë (6). E njëjta me datë 01.03.2022 ka parashtruar kërkesë tek Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxheri i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës duke ju referuar Vendimit me numër 02/1151 të datës 01.12.2006 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa Menaxheri i Personelit i më datë 08.03.2022 me shkresë zyrtare i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme duke kërkuar që të shqyrtohet kërkesa e ankueses sa i përket shtesës në shumën prej 50 euro, ndërsa ankuesja pas heshtjes së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor për realizim të kërkesës-shtesës prej 50 euro bazuar në Vendimin e datës 01.12.2006 me numër protokollit 02/1151, të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ndërlidhur me ankesën e ankueses konstaton se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. *Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë

rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë është shfuqizuar edhe vendimi i datës 01.12.2006, me numër protokolli 02/1151, i nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim të pasqyruar si më lartë, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për realizimin e shtesës në pagë sipas vendimit të datës 01.12.2006, me numër protokolli 02/1151, i nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.415/2022 ,datë 02/06/2022

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

